



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.:419/26, Datë: 03.04.2026

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/L-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ. nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë), nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës nr. 04/L-037 (GZ. nr. 14 / 9 shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative nr. 05/L-031 (GZ. nr. 20 / 12 qershor 2016), Rregullores (AKA)Nr.04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në nivelin Baçelor dhe Master, Rregullores (AKA) Nr.02/2025 për Organizimin dhe Funksonimin e Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së 147-të, të mbajtur më 23.03.2026, mori:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa e Kolegjit Heimerer me Nr.prot.1424/25 datë 04.12.2025 për zgjatjen e periudhës së validimit të akreditimit në nivel institucional edhe për një (1) vit akademik (nga 1 tetor 2027 - 30 shtator 2028).
- II. Aprovohet kërkesa e Kolegjit Heimerer me Nr.prot.1424/25 datë 04.12.2025 për zgjatjen e periudhës së validimit të akreditimit edhe për një (1) vit akademik (nga 1 tetor 2027 - 30 shtator 2028) për programin e studimeve:
 - *Menaxhimi i Institucioneve dhe Shërbimeve Shëndetësore, MSc 120 ECTS;*
- III. Zgjatja e validimit të akreditimit bëhet me kushtet dhe kriteret e njëjta të përcaktuara me vendimin e KShC-së Ref.:958/22 datë 18.07.2022.
- IV. Institucioni i Arsimit të Lartë mbanë përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të vendimit fillestar për validim si dhe të këtij vendim.
- V. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M

Kolegjit Heimerer ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim Nr.prot.1424/25 datë 04.12.2025 për zgjatjen e periudhës së validimit të akreditimit (institucional dhe të programit) edhe për një (1) vit akademik (nga 1 tetor 2027 - 30 shtator 2028) për programin e studimeve:

- *Menaxhimi i Institucioneve dhe Shërbimeve Shëndetësore, MSc 120 ECTS;*

1/2

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e 147-të, të mbajtur më datë 23.03.2026 ka shqyrtuar kërkesën dhe duke u bazuar në arsyeshmërinë e kërkesës, në të cilën Kolegji ka ofruar dëshmi faktike dhe juridike me të cilat është akredituar/riakredituar, institucioni dhe programi në fjalë.

Kërkesa është bërë për vazhdimin e validimit institucional dhe të programit të studimit për një (1) vit akademik (nga 1 tetor 2027 - 30 shtator 2028), bazuar në vendimin e mëparshëm të KShC-së Ref.:958/22 datë 18.07.2022 dhe vlerësimin e Evalag-ut.


Arsyeshmëria e kërkesës: Më 22 mars 2022, Komisioni për Akreditim të Evalag-ut, merr vendim për akreditim ndërkombëtar të Kolegjit Heimerer dhe programit "Menaxhimi i Institucioneve dhe Shërbimeve Shëndetësore, MSc", Periudha e akreditimit ishte 6 Vite prej 09.2022 deri 09.2028 (Shtator 2022 deri shtator 2028. Dëshmi: Certifikata e bashkangjitura të akreditimit ndërkombëtar të Kolegjit Heimerer dhe programit "Menaxhimi i Institucioneve dhe Shërbimeve Shëndetësore, MSc" (të bashkangjitura)

Meqenëse vendimi për validim Ref.:958/22 datë 18.07.2022 ishte lëshuar për periudhën 5 vjeçare, pra 1 vit më pak se sa akreditimi nga Evalag, është bërë duke u bazuar në nenin 19 të UA 15/2018 për akreditimin e IAL-ve në Republikën e Kosovës e cila thotë "Kohëzgjatja e akreditimit programeve është jo më shumë se pesë (5) vjet", dhe tani edhe me Ligjin nr. 08/L-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim, përkatësisht me nenin 35, paragrafin 2. "Kohëzgjatja e riakreditimit të programit është tre (3) ose pesë (5) vjet".

KShC tani ka marr parasysh vlerësimin e Evalag dhe ka vendosur që të zgjatet edhe për një (1) vit validimi i akreditimit për këtë program.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 147 të mbajtur më datë 23.03.2026, ka shqyrtuar kërkesën dhe dokumentacionin relevant të Kolegjit Heimerer dhe duke u bazuar në kërkesën, dispozitat ligjore të lartcekura dhe kompetencat, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.



Prof. Ass. Dr. Hasnija Ilazi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit Heimerer;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.